



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 133, Datë 07.04.2023

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 355, DATË 28.12.2022
“MBI MIRATIMIN PARAPRAK TË ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË
“ALBGAZ” SH.A.”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 47, pika 2, të ligjit nr. 102 /2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe proçedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.04.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike me nr. 24/5 prot., datë 05.04.2023 “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 355, datë 28.12.2022 “Mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së “ALBGAZ” sh.a.”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 355, datë 28.12.2022, ndër të tjera, vendosi:
 1. Të miratojë paraprakisht Z. Elvis Ponari si Zyrtar të Përputhshmërisë së “ALBGAZ” sh.a.
 2. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ky miratim, shoqëria “ALBGAZ” sh.a. duhet të depozitojë në ERE:
 - a) Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të “ALBGAZ” sh.a., për emërimin e Z. Elvis Ponari.
 - b) Kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë të nënshkruar mes “ALBGAZ” sh.a. dhe Z. Elvis Ponari.
- ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme, me shkresën nr. 80 prot., datë 11.01.2023.
- Pas korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë, rezulton se ajo ka depozituar dokumentacionin përkatës në përmbushje të kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit nr. 355/2022, si e tillë kjo pikë duhet të shfuqizohet.
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke

përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 355, datë 28.12.2023 “Mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së “ALBGAZ” sh.a.
2. Drejtoria e Gazit Natyror, të njoftojë shoqërinë “ALBGAZ” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI